



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 103/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.02.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-86459-02-09-2021, me objekt “Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan”, me fond limit 6.989.933 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.”

Ankimues: “Flonja” sh.p.k.
Rruga “Bilal Golemi”, Zona Kadastrale Nr.8270, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor fillimisht në rrugë elektronike e më pas e ka dorëzuar fizikisht atë, gjithashtu ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar shkallët e ankimit, duke mos plotësuar kushtet formale të paraqitjes të ankesës.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 10.02.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-86459-02-09-2021, me objekt “*Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor, për Spitalin Psikiatrik "Sadik Dinci" Elbasan*”, me fond limit 6.989.933 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se operatori ekonomik “Flonja” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datë 18.02.2021, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.426/2 prot. dhe nr.426/3 prot, datë 22.02.2021, trajtim i ankesës së operatorit ekonomik

nga ana e autoritetit kontraktor, ku ky i fundit ka refuzuar ankesën me argumentimin se është paraqitur jashtë afateve ligjore të parashikuara nga ligji i prokurimit publik.

II.4. Në datën 24.02.2021 operatori ekonomik ankimues “Flonja” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të tenderit, për procedurat e mësipërme të prokurimit.

Gjithashtu, në ankesën e paraqitur pranë KPP, operatori ekonomik ankimues pranon se *“Shoqëria “Flonja” sh.p.k., ka depozituar fillimisht në formë elektronike, ankesën për DST për këtë procedurë prokurimi....[...]. Në vijim shoqëria jonë depozitoi ankesë me shkrim, protokolluar me nr.426 prot., dt 18.02.2021 dhe pas shqyrtimit të saj, AK me shkresës nr. 426/2 prot., datë 22.02.2021 ka njoftuar vendimin e tij për refuzimin e ankesës, pa e shqyrtuar në themel, pasi është paraqitur tej afateve ligjore”.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Në datën 10.02.2021 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *“Kërkesë për propozim”*, me nr. REF-86459-02-09-2021, me objekt *“Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtime, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan”*, me fond limit 6.989.933 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

III.1.1. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se operatori ekonomik “Flonja” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në datë 18.02.2021, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.2. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.426/2 prot. dhe nr.426/3 prot, datë 22.02.2021, trajtim i ankesës së operatorit ekonomik nga ana e autoritetit kontraktor, ku ky i fundit ka refuzuar ankesën me argumentimin se është paraqitur jashtë afateve ligjore të parashikuara nga ligji i prokurimit publik.

III.1.3. Në datën 24.02.2021 operatori ekonomik ankimues “Flonja” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të tenderit, për procedurat e mësipërme të prokurimit.

Gjithashtu, në ankesën e paraqitur pranë KPP, operatori ekonomik ankimues pranon se *“Shoqëria “Flonja” sh.p.k., ka depozituar fillimisht në formë elektronike, ankesën për DST për këtë procedurë prokurimi....[...]. Në vijim shoqëria jonë depozitoi ankesë me shkrim,*

protokolluar me nr.426 prot., dt 18.02.2021 dhe pas shqyrtimit të saj, AK me shkresës nr. 426/2 prot., datë 22.02.2021 ka njoftuar vendimin e tij për refuzimin e ankesës, pa e shqyrtuar në themel, pasi është paraqitur tej afateve ligjore”.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, dhe 1.1. dhe 6, të Ligjit nr.9643, datët.20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku është parashikuar shprehimisht se: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.” Gjithashtu, në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 78 pika 6, gërma “ç”, përcaktohet se: “Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave. Në çdo rast, vendimi i autoritetit kontraktor i komunikohet me shkrim ankimuesit. Për efekt të shkurtimit të afateve kohore të procesit të ankimit, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës komunikon vendimin ankimuesit edhe në adresën elektronike të përcaktuar prej tij në formularin e ankesës, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së vendimit”. Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 22 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Komunikimi me shkrim” është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen, përfshirë edhe informacionet, që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike”.

III.1.5. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ligjvënësi megjithëse ka parashikuar si formë të komunikimit me shkrim, edhe të dhënat e transmetuara në mënyrë elektronike, ka veçuar në mënyrë eksplicite komunikimin me mjete elektronike, duke përfshirë një sërë elementësh të procesit të zhvillimit të procedurës së prokurimit publik si Publikimi i Njoftimit të Kontratës, zhvillimi i procedurës së prokurimit, vlerësimi i ofertave të dorëzuar nga operatorët ekonomikë etj., por në asnjë rast nuk ka parashikuar paraqitjen e ankimit administrativ me mjete elektronike. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se dorëzimi i ankesës me mjete elektronike nuk gjen zbatim në kuptim të LPP-së.

III.1.6. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues pretendon se fillimisht ka dorëzuar ankesën e tij brenda afateve ligjore, në formë elektronike, pranë autoritetit kontraktor, formë kjo e cila nuk gjen zbatim në ligjin e prokurimit publik, dhe më pas në datë 18.02.2021 ka dorëzuar formularin e ankesës, fizikisht, pranë autoritetit kontraktor.

Referuar formularit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik “Flonja” sh.p.k. në lidhje me modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit, është protokolluar pranë autoritetit kontraktor në datën 18.02.2021. Akoma më tej vetë operatori ekonomik ankimues, në ankesën e paraqitur pranë Komisioni të Prokurimit Publik, pranon se ka dorëzuar ankesë me shkrim pranë autoritetit kontraktor në datë 18.02.2021, konkretisht “Shoqëria “Flonja” sh.p.k., ka depozituar fillimisht në formë elektronike, ankesën për DST për këtë procedurë prokurimi....[...]. Në vijim shoqëria jonë depozitoi ankesë me shkrim,

protokolluar me nr.426 prot., dt 18.02.2021 dhe pas shqyrtimit të saj, AK me shkresës nr. 426/2 prot., datë 22.02.2021 ka njoftuar vendimin e tij për refuzimin e ankesës, pa e shqyrtuar në themel, pasi është paraqitur tej afateve ligjore”.

Referuar shkresës së autoritetit kontraktor nr. 426/3 prot., datë 22.02.2021 dhe nr. 426/2 prot., datë 22.02.2021, të cilat operatori ekonomik i ka bashkëlidhur ankesës së tij pranë KPP, konstatohet se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën me argumentimin se është paraqitur jashtë afateve ligjore të parashikuara nga ligji i prokurimit publik.

Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në dy momente të veçanta të lex specialis, Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në rastin e ankesave kundër vendimeve të autoritetit kontraktor (referuar nenit 63 pika 2 të LPP-së) në të cilën parashikohet se *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkëljen e pretenduar, sipas këtij ligji”* afati procedural për paraqitjen e ankesës pranë këtij të fundit si shkallë e parë e ankimit nis nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni. Ndërkohë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, lex specialis ka parashikuar se llogaritja e afateve të ankimit nis nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe se operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paraqesin ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe jo nga dita e nesërme e punës, konkretisht *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.”*

K.P.P. gjykon se vetë ligjvënësi ka ndarë dy momentet e mësipërme në lidhje me llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor, ku në rastin e ankimit për dokumentet e tenderit ka parashikuar se llogaritja e afateve nis nga dita e publikimit të njoftimit të kontratës në S.P.E. Referuar datës së publikimit të procedurës së prokurimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dhe datës së dorëzimit të ankesës pranë autoritetit kontraktor mbi modifikimin e dokumentave të tenderit për këtë procedurë, K.P.P. konstaton se ankimi i operatorit ekonomik “Flonja” sh.p.k. është paraqitur jashtë afatit 7 ditor pranë autoritetit kontraktor, kështu që, rrjedhimisht nuk legjitimohet racione temporis. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to

dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj dhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.1.7. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Flonja” sh.p.k. për procedurën e prokurimit *“Kërkesë për propozim”*, me nr. REF-86459-02-09-2021, me objekt *“Shërbim mirëmbajtje objekti ndërtimor, për Spitalin Psikiatrik “Sadik Dinci” Elbasan”*, me fond limit 6.989.933 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 22.02.2021, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 343 Protokoli,

Datë 24.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri